



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 66 prot.

Himarë, më 24.07.2024

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ZBARDHUR NGA
ORGJINALI ,MBAJTUR NË MBLEDHJEN E DATËS 24.07.2024.**

Sot më datë 24.07.2024, ora 10:30 zhvillohet mbledhja e këshillit Bashkiak Himarë. Mbledhja e hapur.

Të ftuar kryetari Bashkisë, drejtoritë, kryetarët e fshatrave.

Marrin pjesë këshilltarët: 1. Aleks Llazari, 2. Miltiadh Prifti, 3. Afrovita Dhimojani, 4. Timoleo Gërdhuqi, 5. Dhimitër Kapaj, 6. Elisabeta Lamaj, 7. Milto Nika, 8. Artan Bala, 9. Gjergji Iliadhi, 10. Thodhori Foto, 11. Artionil Shirokaj, 12. Fuat Mati, 13. Lenica Kocani, 14. Thëllëza Kokaveshi, 15. Silva Burbo.

Mungojnë: 1. Mirka Gjiçali, 2. Nertila Hësi, 3. Loreta Isufi, 4. Nikolin Laska, 5. Qirjako Mërkuri, 6. Maks Vlasi.

Mbledhjen e hap Kryetari Këshillit Z. Dhimitër Kapaj.

Përshëndetje të gjithëve! Jeni dakort me rendin e ditës? Po:- këshilltarët.

Miratohet rendi ditës.

Pika 1. Shqyrtimi i ndryshimeve buxhetore qershor 2024.

A' ka kaluar në komision?

Kryetari komisionit Z. Gjergji Iliadhi :- nuk u shqyrtuan në komision sepse mungonin anëtarët e komisionit.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:- në mbledhjen e kryesisë kërkuam informacion nga drejtoria e financës ,që të bësh rishqyrtim buxheti do dhjetë ditë dhe të duam ne ta kalojmë, kanë kaluar afatet, ka qënë për shqyrtim që në muajin qershor.

Kryetari këshillit jep leje përgjegjësit e financës Z. Uran Dulaj: - Ndryshimet buxhetore i kemi pasqyruar në materialet që keni marrë.

Nuk kalon rishqyrtimi i buxhetit nga këshilltarët.

Pika 2. Shqyrtimi për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025- 2027

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:- nuk mund të mbledhemi këtu e të çojmë duart lart për dy pikat më lart pasi nuk kemi informacionin përkatës ,në mbledhjen e kryesisë I kërkova drejtoritë të financës material shpjegues në lidhje me ndryshimet buxhetore dhe tavanet.

Këshilltari Milto Nika :- Asnjë nga ne këtu nuk është ekspert i ekonomisë për të dhënë një informacion për këtë ,le të na i shpjegoj drejtoria përkatëse.

Kryetari këshillit :- këto dy pika nuk kalojnë.

Pika 3.Shqyrtimi për miratimin e rregullores së menaxhimit të mbetjeve voluminoze në Bashkinë Himarë.

Kryetari këshillit :- as kjo temë nuk ja kaluar në komision. Sekretarja këshillit :- nuk u plotësuar kuorumi i anëtarëve të komisionit.

Pika 4. Informacion për marrjen e masave të zjarreve për sezonin turistik 2024.

Këshilltarja Silva Burbo:- në zonën e Dhërmiut do të shkojë një zjarrfikëse,dua të di është nga gjendja aktuale apo?

Kryetari Z.Arqilea Bollano :- është nga gjendja aktuale.

Pika 5.Shqyrtimi ndihmës ekonomike 6% për periudhën 1-30 qershor.

Këshilltarja Thëllëza Kokaveshi :- çfarë është kjo shifër qesharake ?

Përgjegjëse Aida Halili :-,është me VKM , nuk i caktojmë ne.

Në buxhetin e ardhshëm mund të miratoni një buxhet për ndihmat sociale.

Këshilltari Milto Nika:- marrin ndihmë ekonomike njerzit që nuk plotësojnë kriteret dhe shumë njerëz me aftësi të kufizuara nuk përfitojnë ,ata njerëz që marrin tokë nuk duhet të marrin ndihmë ekonomike.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- duhet të parashikohet në buxhet ndihmë sociale.

Z.Arqilea Bollano :- që të realizohet kjo ka disa kriteret t'i rishqyrtojë dhe t'i sjellim në këshill.

Znj.Aida Halili ndryshon ndihma ekonomike nga ndihma sociale.

Miratohet vendimi nr.22 mbi ndihmën ekonomike nga fondi 6% për periudhën 1-30 qershor.

Të ndryshme.

Kryetari këshillit lexon kërkesën e kryesisë së fshatit Pilur.Kërkesa e Z. Pandeli Nikolla e sjell në këshill për shqyrtim nëpërmjet këshilltarit Timoleo Gërdhuqi për emërtim të sheshit Pilur. Artionil Shirokaj dhe Dhimitër Kapaj janë kundër.

Sekretarja e Këshillit kërkon të leje të flas drejtori juridik,nuk ju mor në konsiderat.

Miratohet kërkesa e kryesisë së fshatit Pilur për emërtim të qendrës së fshatit me nr.23 Vendim.

Shqyrtohet kërkesa e Kryetarit të fshatit Vuno Z.Marko Kaçalli,pasi Kryetari i mëparshëm në detyrë nuk i liron zyrën dhe nuk i dorëzon materialet përkatëse. Kryetari Z .Arqilea Bollano:- Çështja do të zgjidhet sa më shpejt.

Kryetari këshillit mbyll mbledhjen.

Sekretari

Elena Memushaj

